



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 80

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 30 maj 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 16.5.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar..... 4981
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 446, datë 10.5.2018	Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë Terminali i Autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të Terminalit të Autobusëve..... 4981
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7779/1, datë 24.5.2018	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012, “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”, të ndryshuar..... 4993
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7780/1, datë 24.5.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar..... 4994
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 18, datë 21.5.2018	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018–2019..... 4999
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 35, datë 22.5.2018	Për fillimin e procedurës për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kavajë sh.a..... 5007
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 36, datë 22.5.2018	Për fillimin e procedurës për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjellës Tropojë sh.a..... 5008

**VENDIM****Nr. 277, datë 16.5.2018****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”, zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për rininë”.

2. Pikat 11/1 dhe 11/2 ndryshohen si më poshtë vijon:

“11/1. Ministria përgjegjëse për rininë administron procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjet e radhës, për çdo institucion të administratës shtetërore, deri në 200 praktikantë në çdo vit buxhetor, bazuar në kërkesat e institucioneve për punësimin e praktikantëve për 1 (një) vit kalendarik dhe numrin e praktikantëve që kanë kryer me sukses programin kombëtar të praktikave të punës.

11/2. Ministria përgjegjëse për rininë dërgon në ministrinë përgjegjëse për financat numrin e praktikantëve që do të punësohen në çdo institucion të administratës shtetërore, në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës për çdo vit buxhetor. Ministria përgjegjëse për financat njofton degët e thesarit për numrin e praktikantëve që do të paguhën brenda fondeve të miratuara për institucionin përkatës në ligjin vjetor të buxhetit.”.

3. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Praktikantët e punësuar, për efekt pagese, klasifikohen jo më lart se niveli i specialistit të kategorisë IV-b. Fondet e nevojshme financiare për zbatimin e pikave 11/1 dhe 11/2, të këtij vendimi, përballohen nga fondet e buxhetit të miratuara për institucionet e administratës

shtetërore për shpenzimet e personelit, për vitin përkatës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

UDHËZIM**Nr. 446, datë 10.5.2018****PËR KATEGORIZIMIN, KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË TERMINALI I AUTOBUSËVE, AUTORIZIMI, MËNYRA E MBAJTJES SË DOKUMENTACIONIT, TARIFAT DHE DETYRIMET E TJERA TË TERMINALIT TË AUTOBUSËVE¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 21/1 dhe 21/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**Neni 1**
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve.

Neni 2
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim, ndërsa kur termat e mëposhtëm përdoren në tekstin e këtij udhëzimi, kanë kuptim si më poshtë:

a) “Ministri” është ministria përgjegjëse për veprimtarinë e transporteve;

b) “Ministër” është ministri i ngarkuar me përgjegjësi për veprimtarinë e transporteve;

¹ Ky udhëzim është përafëruar pjesërisht me rregulloren nr. 181/2011 (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2011, në lidhje me të drejtat e udhëtarëve në transportin me autobus dhe ndryshon rregulloren nr. 2006/2004, CELEX 32011R0181, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 55, datë 8.2.2011, faqe 1–12.



c) “Njësia e menaxhimit të terminalit” (NJMT) është një operator ose njësi organizative përgjegjëse për funksionimin e një terminali të caktuar;

d) “Person i paaftë” ose “Person me lëvizshmëri të kufizuar” është një person, lëvizshmëria e të cilit duke përdorur transportin është e kufizuar, si rezultat i një paaftësie fizike (të ndjeshmërisë ose të lëvizshmërisë, e përhershme ose e përkohshme), paaftësi ose dëmtim mendor ose çdo shkak tjetër të paaftësisë ose si pasojë e moshës, kur një gjendje e tillë kërkon kujdesin dhe përshtatjen e duhur për nevoja të veçanta të shërbimeve të ofruara për të gjithë udhëtarët;

e) “Zona/territori e/i terminalit” është sipërfaqja e përcaktuar për objektet dhe shërbimet në funksion të aktivitetit të terminalit;

f) “*Kiss and ride*” është një shesh i shënuar me sinjalistikën përkatëse (jashtë territorit të terminalit), për të lejuar zbritjen/lënien dhe hipjen/marrjen e udhëtarëve nga automjeti (taksi, autoveturë private, etj.) dhe për të vazhduar/kompletuar më tej udhëtimin me një transport publik me autobus.

Neni 3

Kategorizimi i terminaleve

1. Terminalët e autobusëve ndahen në:

KATEGORIA A

Terminale shërbimi me kapacitet (fluks) vjetor nga 3.000.000 deri në 10.000.000 udhëtarë. Këto terminale duhet të sigurojnë:

a) Sipërfaqe minimale totale të përdorshme të instalimeve, vendqëndrimi dhe manovrimi 1501–6000 m²;

b) 21–60 vende stacionimi autobusësh për hipje-zbritje udhëtarësh;

c) Ambient i përshtatshëm për qëndrimin e udhëtarëve >80 m².

KATEGORIA B

Terminale shërbimi me kapacitet (fluks) vjetor nga 1.000.000 deri në 3.000.000 udhëtarë. Këto terminale duhet të sigurojnë:

a) Sipërfaqe minimale totale të përdorshme të instalimeve, vendqëndrimi, si dhe manovrimi 901–1500 m²;

b) 10–20 vende stacionimi autobusësh për hipje-zbritje udhëtarësh;

c) Ambient i përshtatshëm për qëndrimin e udhëtarëve >60 m².

Faqe | 4982

KATEGORIA C

Terminale shërbimi me kapacitet (fluks) vjetor nga 150.000 deri në 1.000.000 udhëtarë. Këto terminale duhet të sigurojnë:

a) Sipërfaqe minimale totale të përdorshme të instalimeve, vendqëndrimi dhe manovrimi 301–900 m²;

b) 4–9 vende stacionimi autobusësh për hipje-zbritje udhëtarësh;

c) Ambient i përshtatshëm për qëndrimin e udhëtarëve >40 m².

KATEGORIA D

Terminale shërbimi me kapacitet (fluks) vjetor deri në 150.000 udhëtarë. Këto terminale duhet të sigurojnë:

a) Sipërfaqe minimale totale të përdorshme të instalimeve të ndërtimit, vendqëndrimi, si dhe manovrimi 300 m²;

b) 1–3 vende stacionimi autobusësh për hipje-zbritje udhëtarësh;

c) Ambient i përshtatshëm për qëndrimin e udhëtarëve >20 m².

Shënim. Kategorizimi mund të bëhet sipas numrit të popullsisë së bashkive.

(Terminale shërbimi për qytetet me popullsi mbi x banorë).

Një opsion tjetër është edhe fluksi i autobusëve/1 orë (në oraret e pikut/e fluksit të udhëtarëve):

a) Deri në 20 autobusë për orë, për terminale të vogla;

b) Deri në 30 autobusë për orë, për terminale të mesme; dhe

c) Mbi në 30 autobusë për orë, për terminale të mëdha.

2. Terminalët duhet të sigurojnë një sipërfaqe të domosdoshme për realizimin e qëllimit të tyre, duke bërë të mundur ndërtimin për vend nisjet dhe vend mbërritjet e autobusëve, ndërtim për ambiente administrate dhe shërbimi, hapësira parkimi me mundësi për qëndrim afatshkurtër dhe afatgjatë të mjeteve (nëntokësore ose në ambiente të hapura), manovrimi, servisi etj.

Neni 4

Kushte të përgjithshme

1. Kushte të përgjithshme që duhet të plotësohen, pavarësisht kategorisë së terminaleve, janë:



a) Të gjithë operatorët që përdorin terminalin duhet ta kryejnë aktivitetin e tyre brenda ndërtesës/territorit të përcaktuar të terminalit;

b) Në ambientet e brendshme të terminalit lejohet të operojnë vetëm automjetet e përcaktuara në rregulloren e funksionimit të terminalit (si p.sh., për shërbime taksi, autoambulanca, zjarrfikëse, mjetet e policisë së shtetit, mjetet e sigurimit të objektit, mjete të serviseve etj.);

c) Të gjitha automjetet e tjera të udhëtarëve, të punonjësve të terminalit dhe të personave të tjerë, nuk duhet të lëvizin brenda territorit të tij. Përfshirë bëjnë vetëm rastet e veçanta, të cituara në shkronjën “b” të këtij neni;

d) Shërbimet që nevojiten për mirëmbajtjen e autobusëve, si edhe furnizimit të tyre me karburant, duhet të vendosen në një hapësirë të përcaktuar të terminalit pa penguar funksionimin normal të ambienteve, të cilat janë të destinuara për qëndrimin dhe lëvizjen e mjeteve dhe të udhëtarëve në terminal;

e) Distanca midis zonës së qëndrimit të udhëtarëve me vendqëndrimin (platformën) e autobusëve, nuk duhet të jetë më e vogël se 6 m.

2. Rregullorja e terminalit përgatitet nga njësi e menaxhimit të terminalit dhe aprovet paraprakisht nga strukturat përkatëse në bashki për çështjet e transportit.

Neni 5

Kushtet minimale teknike dhe të operimit që duhet të plotësojnë terminalet

I. Kushte teknike për të gjitha kategoritë e terminaleve

Terminali, duhet:

a) Të ketë në hyrje tabelën që shënon “Terminali i Autobusëve/(emri i bashkisë)” dhe hartën me territorin administrativ të bashkisë;

b) Të ndodhet në një zonë që të jetë afër rrugëve kryesore, të ketë hapësira dhe një hyrje-dalje të veçantë për të krijuar lehtësi të mjeteve të transportit të udhëtarëve;

c) Të respektojë distancat e përcaktuara sipas kuadrit ligjor përkatës;

d) Të jetë në një zonë ku të ketë vende për shërbime taksi dhe mundësi lidhjeje edhe me llojet e tjera të transportit, që të mundësojë një mobilitet efektiv të udhëtarëve dhe mundësinë e transportit intermodal;

e) Të jetë i mbikëqyrur nga një sistem kamerash;

f) Të ketë një skemë të qarkullimit të sigurt dhe të mundësojë lëvizje sa më të shkurtra për këmbësorët, duke u pajisur me sinjalistikën përkatëse;

g) Të ketë dalje emergjence.

II. Kushte të operimit

Të gjitha kategoritë e terminaleve duhet të kenë:

a) Hapësirë shesh qëndrimi për autobusët që janë në pritje;

b) Parkim automjetesh pranë terminalit, për shërbimin “*Park and Go*”;

c) Zonë të caktuar pranë terminalit për shërbimet e transportit qytetës, rrethqytetës, taksi dhe biçikleta me qira, si dhe për shërbimet e transportit “*Kiss and Ride*”;

d) Ndriçim elektrik ose me energji alternative (diellore) brenda dhe jashtë ndërtesës së terminalit të autobusëve;

e) Hapësirë të mjaftueshme për lëvizjen e autobusëve të pajisur me sinjalistikë vertikale dhe horizontale;

f) Tabelë të lexueshme (elektronike) për oraret e udhëtimit, numrin e vendqëndrimit (platformës) në disa pika të terminalit të autobusëve;

g) Një pikë informuese e pajisur me pajisje të njoftimit zanor, për informimin e udhëtarëve mbi oraret e nisjeve dhe destinacionet;

h) Zyrrë informacioni për udhëtarët;

i) Sportele për shitje të biletave;

j) Në ambientet e terminaleve të ketë makineri për prerjen e biletës në mënyrë elektronike;

k) Sallë pritje për udhëtarë me ajër të kondicionuar;

l) Tualete për meshkuj dhe për femra, si dhe për persona me aftësi të kufizuara;

m) Një dhomë e ndarë “Për nëna me fëmijë”, me tualet, lavaman dhe pajisje të nevojshme;

n) Dhoma të sigurta për pranimin dhe dorëzimin e bagazhit apo ruajtjen e tyre.

o) Kushte të mira higjienike;

p) Kabina me telefona publik;

q) Infrastrukturë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara;

r) Ora për matjen/tregimin e kohës;

s) Ambiente të dedikuara për personelin që shërben në terminal;

t) Terminali mund të ofrojë edhe shërbime hotelerie dhe/ose njësi shitjeje për udhëtarët;



u) “Stacione karrikuese” për mjetet elektrike, si dhe në metodologjitë e reja që përdoren në ndërtimin e infrastrukturave për shërbime, duhet të merret parasysh edhe “eficiencia energjetike”.

v) Shërbim interneti (*Wi-Fi*) pa pagesë në gjithë zonën/territorin e terminalit.

Neni 6

Kushtet e përgjithshme të funksionimit të terminalit

Terminalet projektohen dhe ndërtohen në përputhje me rregullat e projektimit dhe të ndërtimit të terminaleve të autobusëve sipas legjislacionit në fuqi.

1. Tërësia e elementeve përbërëse të terminalit (ndërtesa, sheshe, rrugë qarkullimi, lehtësira të lëvizjeve të udhëtarëve, shkallë ngjitëse dhe zbritëse, kalime apo shërbime të tjera për udhëtarët), konfigurohen me kriterë bazë, për:

a) Plotësimin e qëllimit dhe të funksionimit bazë të terminalit;

b) Mundësinë e evoluimit të shpejtë të teknologjisë;

c) Shërbim për personat që kanë pengesa, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe të shërbimeve për transportues dhe udhëtarët, terminali i autobusëve duhet t'i përmbahet kohës së qëndrimit të transportuesit në vendnisjet dhe vendmbërritjet, si më poshtë:

a) Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues në transportin ndërqytetës është 15 minuta para nisjes;

b) Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues në transportin ndërkombëtar është 30 minuta para nisjes;

c) Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues që shfrytëzojnë terminalin si transit është 15 minuta para nisjes.

3. Qarkullimi i mjeteve brenda hapësirës së terminalit, në hyrje dhe dalje nga terminali, duhet të planifikohet në mënyrë të tillë që të eliminohen problemet e qarkullimit në drejtimet e kundërta në këto rrugë, si dhe të mos kemi kryqëzime të lëvizjes së udhëtarëve me lëvizjen e mjeteve.

4. Rrjedha e qarkullimit të autobusëve, numri dhe largësia e shkallëve ngjitëse dhe zbritëse, vendet e stacionimit të autobusëve (nëse ka) i instalimeve ndihmëse (p.sh., impiante larës dhe lubrifikues etj.), përcaktohen nga projektuesit e

terminalit dhe bëhen subjekt për miratim nga shërbimet/institucionet që lëshojnë lejet përkatëse.

5. Ndërmjet vendnisjeve dhe vendmbërritjeve të autobusëve, por dhe në zonat e transitit të automjeteve, futet domosdoshmërisht një trotuar me gjerësi të paktën 2 m dhe lartësi pak më shumë se 0.15 m, duke pasur platforma të pjerrëta të përshtatshme për shërbimin e përdoruesve (persona me aftësi të kufizuara, transportin e bagazheve etj.). Trotualet duhet të shtrohen me lëndën e duhur dhe të projektuar në mënyrën më të mirë të mundshme, me qëllim që të krijohet lehtësi dhe siguri në lëvizjen e të gjithë përdoruesve dhe, veçanërisht, të përdoruesve të karrocave me rrota dhe mjeteve për persona me aftësi të kufizuara.

6. Lartësia e lirë për transitin e autobusëve nën trarët, portat hyrëse, fiksuesit e tabelave vezulluese, etj. duhet të jetë të paktën 5 m.

7. Rrugët e qarkullimit dhe, përgjithësisht, sipërfaqja e qarkullimit e projektuar duhet të ketë mbulimin e duhur qoftë pjesa e asfaltuar, po ashtu edhe katet e shërbimeve me materialin e duhur dhe të përshtatshëm për të përballuar rëndesën, rezistencën ndaj peshës së automjeteve që lëvizin.

8. Ndërtimi duhet të disponojë instalimet elektrike ndriçuese të përshtatshme. Sistemi i instalimeve elektrike, duhet të sigurojë ndriçim uniform në zonë dhe gradualisht të ambientueshëm me nivelin e ndriçimit nga zona në zonë.

9. Sistemet termoizoluese dhe kulluese të ndërtesës duhet të përballojnë drejtimin dhe sasinë e duhur të rrjedhjeve të ujit në kohë reshjesh me intensitet të lartë. Gjithashtu, duhet të ketë sistemin të kanalizimeve për ujërat e zeza (ambiente të pastërtisë e shëndetit, tualete etj.) dhe duhet t'i nënshtrohet trajtimit të duhur, nëpërmjet elementeve të veçanta.

Neni 7

Detyrimet e njësisë së menaxhimit të terminalit të autobusëve për t'u siguruar kushte transportuesve dhe udhëtarëve

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shërbimeve për transportuesit dhe udhëtarët, njësia e menaxhimit të terminalit të autobusëve, duhet:

a) t'u përmbahet dispozitave të legjislacionit në fuqi;

b) t'u ofrojë të dhëna, personave të autorizuar të ministrisë;



c) t'i raportojë ministrisë dhe strukturave të transportit në bashki, mbi ushtrimin e veprimtarisë në çdo 3 (tre) muaj, për numrin e hyrjeve dhe të daljeve të autobusëve, si dhe të dhëna të tjera të kërkuara nga ministria;

d) të sigurojë kushte për nisjen dhe mbërritjen e autobusëve, sipas orareve të miratuara nga institucionet përgjegjëse përkatëse.

Neni 8

Kriteret e përgjithshme për autorizimin e njësive së menaxhimit të terminalit

1. Kryetari i bashkisë, në territorin administrativ të bashkisë ku është ndërtuar terminali, lëshon autorizimin për njësinë që do të menaxhojë terminalin.

2. Bashkia, bazuar në dispozitat e këtij udhëzimi, duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të specifikuar, kushtet për lëshimin, pezullimin ose heqjen e autorizimit për njësinë që do të menaxhojë terminalin e autobusëve, i cili mund të jetë ose jo pronar i tij.

3. Njësia që do të menaxhojë terminalin, duhet të paraqesë në bashki një kërkesë aplikimi dhe dokumentacionin që provon plotësimin e standardeve teknike të ndërtimit dhe të operimit të kërkuara, sipas kriterëve të përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore/bashkia.

4. Kur aplikuesi për njësinë që do të menaxhojë terminalin, nuk është pronar i truallit, atëherë duhet të paraqesë edhe marrëveshjen/kontratën e qirasë apo të marrëdhënies me truallin.

5. Në rastin kur njësia e vetëqeverisjes vendore, synon ndërtimin dhe operimin e terminalit nëpërmjet një forme bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, me një ose më shumë operatorë ekonomikë, përzgjedhja e operatorit privat do të bëhet nëpërmjet një procedure konkurruese e rregulluar nga legjislacioni për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

6. Në rastin kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka nisur procedura për ofrimin e shërbimit të terminalit të autobusëve nga subjekte shtetërore ose private, para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të respektohen procedurat e përzgjedhura dhe të vendosura nga të dyja palët.

7. Kriteret për dhënien e autorizimit për këto subjekte do të jenë ato të dakordësuara, sipas formës ligjore që kanë zgjedhur palët para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Afati i autorizimit për këto

subjekte duhet të përkojë me afatet e përfundimit të formës ligjore që kanë zgjedhur palët për ofrimin e shërbimit të terminalit të autobusëve.

Neni 9

Mbikëqyrja e terminalit

Bashkia, me urdhër të kryetarit, përcakton një punonjës nga drejtoria/sektori i transportit të mbikëqyrë aktivitetin e terminalit, duke dhënë informacion çdo 6 muaj për kryetarin e bashkisë mbi ecurinë e aktivitetit të terminalit.

Neni 10

Mbajtja e dokumentacionit

Njësia menaxhimit të terminalit, duhet të krijojë, të përditësojë dhe të mirëmbajë në mënyrë elektronike regjistrin e të dhënave, ku përfshihen:

a) Emrat e subjekteve transportuese që operojnë në terminal;

b) Emërtimin e linjës (O/D), me stacionet e ndërmjetme dhe gjatësinë e linjës;

c) Oraret dhe frekuencat;

d) Numrin e autobusëve në punë, vitin e prodhimit dhe targat e autobusëve;

e) Numrin e udhëtarëve që udhëtojnë; si dhe

f) Çdo dokument tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të terminalit.

Neni 11

Mundësia e hyrjes dhe informacioni

1. Në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të kufizuar, transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, aty ku është e përshtatshme nëpërmjet organizatave të tyre, do të krijojnë ose i kanë krijuar, kushte jodiskriminuese hyrje për transportin e personave të paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar.

2. Kushtet e hyrjes ofruar si në paragrafin 1, duke përfshirë kuadrin ligjor kombëtar për krijimin e kërkesave të sigurisë, në të cilat këto kushte jodiskriminuese hyrje janë bazuar, do të bëhen të vlefshme për publikim nga transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, fizikisht ose në internet, në formate të pranueshme me kërkesë, në të njëjtën gjuhë, si ato në të cilat informacioni është bërë i vlefshëm në përgjithësi për të gjithë udhëtarët. Kur ofrohet ky informacion, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet nevojave të personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të kufizuar.



3. Informacioni për kushtet e hyrjet, referuar paragrafit 2, do të shpërndahet fizikisht me kërkesë të udhëtarëve.

Neni 12

Përcaktimi i terminaleve

Bashkia, sipas juridiksionit përkatës, do të përcaktojë terminalat e autobusëve, ku ofrohet asistencë për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar dhe do të informojë ministrinë, e cila do të publikojë në faqen zyrtare listën e këtyre terminaleve.

Neni 13

E drejta për asistencë në terminalat e caktuara dhe në bordin e autobusëve

1. Subjekt të kushteve të mundësisë së hyrjes ofruar në nenin 11(1), transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, në terminalat e caktuara nga bashkia përkatëse, do të ofrojnë asistencë pa pagesë për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, të paktën në nivelin e specifikuar në shkronjën “a”, të shtojcës I.

2. Subjekt të kushteve të mundësisë së hyrjes, ofruar në nenin 11(1), transportuesit, do të ofrojnë në bordin e autobusëve asistencë pa pagesë për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, të paktën në nivelin specifikuar në shkronjën “b” të shtojcës I.

Neni 14

Kushtet nën të cilat jepet ndihma për personat me aftësi të kufizuara

1. Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të sigurojnë ndihmë për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, me kusht që:

a) Nevoja e personit për ndihmë t’i njoftohet transportuesit, njësisë menaxhuese të terminalit, agjentëve të udhëtimit në 36 orët e fundit përpara se ndihma të jetë e nevojshme; dhe

b) Personat e interesuar paraqiten vetë në pikën e caktuar:

i) në kohën e përcaktuar paraprakisht nga transportuesi, që duhet të jetë jo më shumë se 60 minuta para kohës së publikuar të nisjes ose në një periudhë më të shkurtër nëse është rënë dakord ndërmjet transportuesit dhe udhëtarit; ose

ii) në qoftë se nuk ka kohë të përcaktuar, jo më vonë se 30 minuta para kohës së publikuar të nisjes.

Faqe | 4986

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, njoftojnë transportuesin, agjentin e udhëtimeve ose operatorin turistik në kohën e rezervimit ose, paraprakisht, bëjnë blerjen e biletës së përcaktuar për nevojat e tyre të veçanta, me kusht që nevoja të jetë e njohur në atë kohë.

3. Transportuesit, njësia e menaxhimit të terminalit, agjentët e udhëtimit dhe operatorët turistikë do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar marrjen e njoftimeve të nevojës për ndihmë, të bëra nga personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar. Ky detyrim do të zbatohet në të gjitha terminalat e caktuara dhe pikat e tyre të shitjes, duke përfshirë shitjen me telefon dhe përmes internetit.

4. Nëse njoftimi nuk bëhet në përputhje me shkronjën “a”, të paragrafit 1 dhe të paragrafit 2, transportuesit, njësia e menaxhimit të terminalit, agjentët e udhëtimit dhe operatorët turistikë, do të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që ndihma është dhënë në një mënyrë të tillë, që personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar janë në gjendje të hipin në shërbimin e rezervuar, duke ndryshuar shërbimin përkatës apo të zbresin nga shërbimi i mbërritjes, për të cilin ata kanë blerë një biletë.

5. Njësia e menaxhimit të terminalit do të caktojë një pikë brenda ose jashtë terminalit, në të cilën personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar mund të lajmërojnë ardhjen e tyre dhe të kërkojnë ndihmë. Pika duhet sinjalizuar në mënyrë të qartë dhe të ofrojë informacion bazë për terminalin dhe ndihmën e dhënë, në formate të pranueshme.

Shënim. Mund të shtohen referenca sipas planit 5-vjeçar kombëtar të veprimit për PAK-në, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 29.6.2016, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020”, Fletorja Zyrtare 124/2016.

Neni 15

Transmetimi i informacionit te palët e treta

Në qoftë se agjenti i udhëtimit ose tur operatorët marrin një njoftim referuar sipas shkronjës “a”, të nenit 14(1), ata, brenda orarit zyrtar normal të tyre, do të transferojnë informacionin te transportuesit ose njësia e menaxhimit të terminalit, sa më shpejt të jetë e mundur.



Neni 16 Trajnimi

Transportuesi dhe, kur është e nevojshme, njësia e menaxhimit të terminalit, do të vendosin procedurat e trajnimit për t'u ardhur në ndihmë personave të paaftë, duke përfshirë udhëzimet dhe duke siguruar që personeli i tyre:

a) I ndryshëm nga drejtuesit, duke përfshirë ato të punësuar nga çdo palë tjetër, duke siguruar ndihmë të drejtpërdrejtë për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar janë trajnuar ose janë udhëzuar, siç përshkruhet në shkronjat “a” dhe “b”, të shtojcës II; dhe

b) Duke përfshirë edhe drejtuesit, të cilët merren drejtpërdrejt me udhëtimet publike apo në lidhje me publikun që udhëton, janë të trajnuar ose të udhëzuar, siç përshkruhet në shkronjën “a”, të shtojcës II.

Neni 17 Kompensimi lidhur me karriget me rrota dhe pajisjeve të tjera të lëvizshmërisë së personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të kufizuar

1. Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit do të jenë përgjegjës, në rastet kur ata janë shkaktarë të humbjeve ose të dëmtimit të karrigeve me rrota, pajisjeve të tjera të lëvizshmërisë ose pajisjeve ndihmëse. Humbja ose dëmtimi do të kompensohen nga transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, përkatësisht përgjegjës për atë humbje ose dëmtim.

2. Kompensimi, referuar paragrafit 1, do të jetë i njëjtë me koston e zëvendësimit ose të riparimit të pajisjeve të humbura ose të dëmtuara.

3. Kur është e nevojshme çdo përpjekje do të ndërmerret me shpejtësi duke ofruar zëvendësimin e përkohshëm të pajisjeve. Karriget me rrota, pajisjet e tjera të lëvizshmërisë ose pajisjet ndihmëse, kur është e mundur, do të kenë të njëjtat tipare dhe funksion teknik me ato të humbura ose të dëmtuara.

Neni 18 Informimi në rast të anulimit të udhëtimit

1. Në rast të anulimit ose të vonës në nisjen e një shërbimi të rregullt, udhëtarët që nisen nga terminali do të informohen nga transportuesi ose, kur është e përshtatshme, nga njësia e menaxhimit të terminalit, të situatës së krijuar sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 30

minuta pas kohës së planifikuar të nisjes dhe të kohës së vlerësuar të nisjes, duhet që sa më shpejt ky informacion të jetë në dispozicion.

2. Në qoftë se udhëtarët humbasin, sipas rendit të udhëtimit, një shërbim që nis për shkak të një anulimi apo vonese, transportuesit ose, kur është e përshtatshme, njësia e menaxhimit të terminalit, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të informuar udhëtarët në fjalë në lidhje me alternativat.

3. Transportuesit ose, sipas rastit, njësia e menaxhimit të terminalit, do të sigurojnë që personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar të marrin informacionin e kërkuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 në formate të mundshme për t'u përdorur.

4. Kur është e mundur, informacioni i kërkuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 do të sigurohet me mjete elektronike për të gjithë udhëtarët, duke përfshirë edhe ato që nisen nga stacionet e autobusëve, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1, nëse udhëtari e ka kërkuar këtë dhe janë kusht që detajet e nevojshme të kontaktit t'i jepen transportuesit.

Neni 19 Asistencë në rast të anulimit ose të vonimit të nisjes

1. Për një udhëtim të një kohëzgjatjeje të caktuar prej më shumë se 3 orësh, transportuesi, në rast të anulimit ose të vonës në nisje nga një terminal prej më shumë se 90 minuta, u ofron udhëtarëve pa pagesë:

a) Në mënyrë të përshtatshme, me ushqim dhe pije freskuese, gjatë kohës së pritjes apo të vonës, me kusht që ato të jenë në dispozicion në autobus ose në terminal, ose të mund të furnizohen në mënyrë të përshtatshme.

b) Një dhomë hoteli apo strehim, si dhe ndihma për të rregulluar transportin midis terminalit dhe vendit të akomodimit, në rastet kur një qëndrim nga 1 ose më shumë në të bëhet i nevojshëm. Për çdo udhëtar, transportuesi mund të kufizojë koston totale të akomodimit, duke mos përfshirë transportin nga terminali për në vendin e akomodimit, për një natë dhe në një maksimum prej 2 netësh.

2. Në zbatim të këtij neni, një vëmendje të veçantë, transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit do t'u kushtojnë nevojave të personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të kufizuar, si dhe çdo personi shoqëruar të tyre.



Neni 20

E drejta e informimit për udhëtimin

Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, brenda zonave të tyre përkatëse të përgjegjësisë, u sigurojnë udhëtarëve informacion të përshtatshëm gjatë gjithë udhëtimit të tyre. Kur është e mundur, ky informacion do t'i sigurohet në formate të mundshme për t'u përdorur, sipas kërkesës.

Neni 21

Informacion mbi të drejtat e udhëtarëve

1. Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, brenda zonave/territorit të tyre përkatës të përgjegjësisë, sigurojnë që udhëtarë të jenë të pajisur me informacionin e duhur dhe të kuptueshëm në lidhje me të drejtat e tyre, sipas rregullores së brendshme të funksionimit të terminalit, për vonesën në nisje. Ky informacion duhet të sigurohet në terminale dhe kur është e aplikueshme, në internet. Me kërkesë të një personi të paaftë ose personi me lëvizshmëri të kufizuar, informacioni do t'i ofrohet, kur është e mundur, në një format të përshtatshëm. Ky informacion do të përfshijë detajet e kontaktit të organit të zbatimit apo të organeve të caktuara nga autoriteti kompetent.

2. Me qëllim plotësimin e informacionit të kërkuar në paragrafin 1, transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit mund të përdorin një përmbledhje të dispozitave të këtij udhëzimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze dhe të bëjnë të vlefshme për të interesuarit.

Neni 22

Ruajtja e dispozitave të tjera në fuqi

Përveç përcaktimit të këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të kenë të njëjtën forcë dhe nuk preken aktet ligjore për kujdesin shëndetësor, për shërbimin zjarrfikës, si dhe ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e ambientit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjilknuri

SHTOJCA I**MBËSHTETJA PËR PERSONAT E PAAFTË
OSE PERSONAT ME LËVIZSHMËRI TË
KUFIZUAR****a) Ndihma në terminale të caktuara**

Ndihma dhe masat e nevojshme për t'u mundësuar personave të paaftë ose me lëvizshmëri të kufizuar, në:

- komunikimin e ardhjes së tyre në terminal dhe kërkesën e tyre për ndihmë në pika të caktuara;
- lëvizjen nga pika e caktuar kontrolluese, duke pritur në dhomën dhe zonën e hipjes;
- hipjen në automjet, me ofrimin e ashensorëve, karrigeve me rrota ose ndihmë tjetër të nevojshme, sipas rastit;
- ngarkesën e bagazheve të tyre;
- rimarrjen e bagazheve të tyre;
- zbritjen nga mjeti;
- caktimin e një posti parkimi për këta persona pa pagesë/ose për disa orë.

b) Mbështetje në bordin e autobusit

Ndihma dhe masat e nevojshme për të mundësuar personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, në:

- pajisjen me informacion thelbësor në një udhëtim në formate të mundshme për t'u përdorur, në varësi të kërkesës së udhëtarit;
- hipjet/uljet gjatë pushimeve në një udhëtim, nëse ka personel tjetër si drejtues në bord.

SHTOJCA II**TRAJNIMI NË LIDHJE ME
AFTËSITË E KUFIZUARA****a) Ndërgjegjësimi për trajnimin lidhur me aftësitë e kufizuara**

Trajnimi i stafit që merret direkt me publikun që udhëton, përfshin:

- ndërgjegjësimin dhe përgjigjet e përshtatshme për udhëtarët me paaftësi fizike, shqisore (të dëgjimit dhe vizuale), të fshehura, duke i mundësuar të bërit e dallimit në mes të aftësive të ndryshme të personave të cilët lëvizshmërinë, orientimin ose komunikimin e kanë të reduktuar;
- pengesat me të cilat ballafaqohen personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, duke përfshirë pengesat në qëndrim, mjedisore/fizike dhe organizative;
- njohjen e qenve ndihmës, duke përfshirë rolin dhe nevojat e një qeni ndihmës;
- dukuritë e papritura;



- aftësitë personale dhe metodat e komunikimit me njerëzit që nuk dëgjojnë dhe njerëzit me dëmtime dëgjimi, njerëzit me dëmtime shikimi, njerëzit me dëmtime në të folur dhe njerëzit me aftësi të kufizuara të të mësuarit;

- se si të merren me karrige me rrota dhe mjetet e tjera lëvizëse duke pasur kujdes në mënyrë që të shmangen dëmtime (nëse ka, për të gjithë stafin të cilët janë përgjegjës për trajtimin e bagazhit).

b) Ndhimja për trajnimin e aftësisë së kufizuar

Trajnimi i stafit i përfshirë drejtpërdrejtë në ndihmën ndaj personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të reduktuar ku përfshin:

- si të ndihmojnë përdoruesit e karrigeve me rrota të bëjnë lëvizje brenda dhe jashtë një karrigeje me rrota;

- aftësitë për ofrimin e ndihmës për personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar, që të udhëtojnë me një qen ndihmës të njohur, duke përfshirë rolin dhe nevojat e këtyre qenve;

- teknikat për shoqërimin e udhëtarëve me shikim të dëmtuar dhe për trajtimin dhe transportin e qenve të ndihmës të njohur;

- të kuptuarit e llojeve të pajisjeve, të cilat mund të ndihmojnë personat e paaftë ose personat me lëvizshmëri të kufizuar dhe një njohuri se si trajtohet një pajisje e tillë;

- njohja e procedurave të asistencës që ruajnë sigurinë dhe dinjitetin e personave të paaftë ose personave me lëvizshmëri të kufizuar;

- të kuptuarit e nevojës për ndihmë të besueshme dhe profesionale;

- njohja e ndihmës së parë.

SHTOJCA III

TARIFAT E TERMINALEVE

Terminali duhet të jetë i hapur dhe transparent ndaj të gjithë operatorëve në aplikimin në mënyrë jodiskriminuese të tarifave të shërbimit të caktuar. Operatorët, të cilët kanë fituar të drejtën e operimit të terminalit të autobusëve, para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, sipas formave ligjore të përzgjedhura me njësinë e vetëqeverisjes vendore, aplikohen tarifat e shërbimit të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, bazuar në nenin 54, shkronjën “P”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” ose sipas tarifave të miratuara në studimin e fizibilitetit nga autoriteti përgjegjës.

Tarifat e paraqitura në këtë udhëzim, janë orientuese/referuese, në varësi të territorit dhe numrit të popullsisë të bashkive/qyteteve, numrit të udhëtarëve dhe kategorive të terminaleve.

Tarifat duhet t'i referohen edhe nenit 14, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku përcaktohet se niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Më poshtë jepen tarifa për shërbimet që ofrohen në terminalet e autobusëve, të cilat janë:

TARIFAT PËR BAGAZHET QË RUHEN NË DHOMËN E SIGURISË.

Shërbimi i ruajtjes së sigurt të bagazheve do të operojë çdo ditë nga ora 04:00 deri në 23:00 (çmimet varen nga pesha e bagazheve dhe zgjatja kohore e ruajtje së tyre).

Euro

Kohëzgjatja	Për bagazh
Ora e parë	1,00 €
Për çdo orë shtesë	0,50 €
24 orë ruajtje	7,00 €
Pesha	
≤ 10 kg	1,00 €
10–30 kg	1,5 €
30–50 kg	2 €
≥ 50 kg	2,5 €
Transferimi i bagazheve ndërmjet zonave të terminalit	2,00 €
Transferimi e bagazheve jashtë territorit të terminalit (jo më tepër se 500 m)	5,00 €

* TVSH e përfshirë në çmim.

* Lista e çmimeve mund të ndryshojë sipas vendimit të administratorit/menaxherit të terminalit.

* Për çdo orë shtesë të ruajtjes/mbajtjes së bagazheve: 0.50 euro.



TARIFAT E PARKIMIT

(Këto tarifa do të mbliidhen për llogari të njësisë menaxhuese të terminalit.)

Euro

Kohëzgjatja	Për mjet
Deri në 1 orë	1,50 €
Çdo orë shtesë	1,00 €
Parkim natën (24:00–06:00)	3,00 €
24 orë parkim	10,00 €
Shtesë për 24 orë	5,00 €

* Parkimi për personat me aftësi të kufizuar është pa pagesë/ ose i reduktuar pa pagesë për disa orë.

KONTRATA MUJORE

Euro

Kohëzgjatja	Për mjet
1 muaj	50,00 €
3 muaj	125,00 €
6 muaj	250,00 €

PARAPAGIM ME KARTË

Euro

Kohëzgjatja	Për mjet
1–10 ditë	30,00 €
10–20 ditë	40,00 €
20–30 ditë	50,00 €

Motoçikletat mund të parkojnë në një vend të caktuar, pa pagesë, përballë zonës së nisjes/së mbërritjes.

PAGESA PËR PASTRIMIN E TERRITORIT TË TERMINALIT

(Sipas tarifave të vendosura nga njësia e menaxhimit të terminalit.)


Shënim. Raporti euro/lekë do të jetë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018 (ose të vendosen në monedhën në lekë me vendim të Këshillit Bashkiak ose nga njësia e menaxhimit të terminalit).

Euro

PAGESAT	
Për subjekt transporti të licencuar për transport rrugor udhëtarësh me autobus, janë si më poshtë:	
1. Për mbërritjen dhe nisjen e autobusit të një transportuesi të licencuar për të operuar në:	
a) Linjat e rregullta brenda vendit (rrethqytetëse, ndërqytetëse), të rregullta të specializuara, të transportit të rastit.	3,00 €
b) Linjat e rregullta ndërkombëtare, të rregullta të specializuara, të transportit të rastit.	3,00 €
2. Për mbërritjen dhe nisjen e autobusit të një transportuesi të autorizuar për të operuar në linjat e rregullta ndërkombëtare me kalim transit nëpër territorin e vendit tonë.	7,00 €
Shënim. Çdo transportues i licencuar për transport rrugor udhëtarësh me autobus, duhet të ketë nënshkruar kontratë me njësinë e menaxhimit të terminalit për shërbimet e ofruar nga terminali.	

SHTOJCA IV

Llogaritja e hapësirës së një vendqëndrimi, sugjerohet të bëhet duke marrë parasysh përmasat e autobusit. Në rastin e autobusëve me përmasat 13.0m x 3.0m, manualët teknike këshillojnë një hapësirë të nevojshme prej 70 m². Kjo hapësirë përfshin hapësirën e vendqëndrimit (*berth dimensions*) dhe hapësirën e nevojshme për manovrimin e autobusit për në/nga vendqëndrimi (*interval dimensions*).

SKEME E THJESHTUAR

SIPERFAQJA E PERGJITHESHME: 34 X 33 = 1122 M²

NUMRI I VENQENDRIMEVE 16

PERMASAT E AUTOBUZIT: 13 M X 3 M



SHTOJCA V
TABELA PËRMBLEDHËSE E QARKULLIMIT VJETOR TË UDHËTARËVE SIPAS
QARQEVE

AUTOBUSË LINJAT INTERURBANE		
Qarku/bashkia Qendër/bashkitë përbërëse	Përpunim udhëtarë në terminal të përlogaritur, viti 2016	
	Volumi ditor hyrje-dalje	Volumi vjetor hyrje-dalje
BERAT (Q)	9.429	3.441.585
BERAT (BQ)	5.929	2.164.085
ÇOROVODË	750	273.896
KUÇOVË	1.806	659.190
POLIÇAN	672	245.280
URA VAJGURORE	272	99.134
DIBËR	1.623	592.249
BULQIZË	378	137.970
BURREL	605	220.752
KLOS	265	96.579
PESHKOPI	1.439	525.308
DURRËS	16.211	5.916.869
DURRËS	12.347	4.506.509
KRUJË	1.176	429.240
RINAS	728	265.720
SHIJAK	1.960	715.400
ELBASAN	15.459	5.642.462
BELSH	707	258.055
CËRRIK	1.365	498.225
ELBASAN	9.758	3.561.670
GRAMSH	801	292.292
LIBRAZHD	896	327.040
PEQIN	511	186.515
PËRRENJAS	1.421	518.665
FIER	16.072	5.866.280
BALLSH	1.204	439.460
DIVJAKË	581	212.065
FIER	9.114	3.326.610
LUSHNJË	2.422	884.030
PATOS	1.575	574.875
ROSKOVEC	1.176	429.240
GJIROKASTËR	5.060	1.846.754
DROPULL	252	91.980
GJIROKASTËR	2.822	1.030.176
KËLCYRË	113	41.391
LIBOHOVË	168	61.320
MEMALIAJ	588	214.620
PËRMET	654	238.637
TEPELENË	462	168.630
KORÇË	9.085	3.315.879
BILISHT	518	189.070
ERSEKË	542	197.757
KORÇË	5.408	1.973.993
MALIQ	1.176	429.240
POGRADEC	1.176	429.240
PUSTEC	265	96.579
KUKËS	2.961	1.080.765



BAJRAM CURRI	686	250.390
KRUMË	266	97.090
KUKËS	2.009	733.285
LEZHË	5.411	1.975.015
LAÇ	1.498	546.770
LEZHË	3.080	1.124.200
RRËSHEN	833	304.045
SHKODËR	9.323	3.402.749
FUSHË-ARRËZ	889	324.485
KOPLIK	616	224.840
PUKË	1.127	411.355
SHKODËR	5.529	2.017.939
VAU I DEJËS	1.162	424.130
TIRANË	31.658	11.555.243
KAMZË	2.779	1.014.335
KAVAJË	1.358	495.670
RROGOZHINË	147	53.655
TIRANË	26.254	9.582.783
VORË	1.120	408.800
VLORE	13.552	4.946.480
DELVINË	1.981	723.065
FINIQ	168	61.320
HIMARË	644	235.060
KONISPOL	168	61.320
SARANDË	4.305	1.571.325
SELENICË	378	137.970
VLORE	5.908	2.156.420
TOTALI	136.906	49.970.690

Burimi: Instituti i Transportit

UDHËZIM

Nr. 7779/1, datë 24.5.2018

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012, “PËR DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012, “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 6 e nenit 2 riformulohet si më poshtë:

“6. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor kryejnë kontrollin fizik të mjeteve me dy specialistë të saj, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të nenit 80 të Kodit Rrugor, deri në miratimin prej ministrit të organizmave të akredituar në fushën e mjeteve motorike, për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit dhe të kontrollit fizik të mjeteve motorike rrugore e rimorkiove të tyre. Ministria, gjatë një periudhe pesëvjeçare do të miratojë një numër të kufizuar prej jo më shumë se dy organizmash, për të vlerësuar ecurinë e këtij procesi gjatë kësaj periudhe dhe për të ndërmarrë hapat e mëtejshëm. Këta organizma që do të autorizohen për kryerjen e kontrollit fizik të mjeteve motorike rrugore dhe



rimorkiove të ofrojnë këtë shërbim në çdo qendër të kryerjes së kontrollit fizik, me dy specialistë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të nenit 80, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Organizmat mund të disponojnë mjediset ekzistuese pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor për ofrimin e shërbimit, sipas marrëveshjes që do të lidhin me DPSHTRR-në, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

2. Pas pikës 7 të nenit 2 shtohen pikat si më poshtë:

“8. DPSHTRR-ja do të vijojë me përdorimin e certifikatave të kontrollit fizik të lëshuara prej organizmave të miratuar, me fillimin e kryerjes së aktivitetit prej tyre, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

9. Modeli i regjistrave fizikë dhe elektronikë i kontrollit fizik të mjeteve dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm me anë të cilit DPSHTRR-ja kryen këtë shërbim, do të vihen në dispozicion të organizmave të miratuar brenda një afati njëmuor nga miratimi i tyre.

10. Certifikatat e kontrollit fizik të mjeteve të emetuara do të mbajnë të njëjtin formatim, përfshirë numrat serialë, si dhe logon dhe të dhënat e organizmit të miratuar.

11. Certifikata e kontrollit fizik të mjetit, të cilit i është kryer kontrolli fizik, i dorëzohet personit të interesuar, i cili, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndjek procedurat për regjistrimin e mjetit.

12. DPSHTRR-ja dhe organizmat e miratuar bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë për zbatimin me korrektësi të procedurave që lidhen me këtë shërbim.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri

UDHËZIM

Nr. 7780/1, datë 24.5.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1649, DATË 16.8.1999, “MBI PLOTËSIMIN E DISA KUSHTEVE TË VEÇANTA NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 5, të nenit 9, paragrafi i parë, të nenit 36, të nenit 37, të nenit 38, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë i pikës 8(a), të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë:

“8 a) Për kontrollin në plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve, organi i akredituar në fushën e mjeteve motorike rrugore dhe i miratuar nga ministri për kryerjen e veprimtarive specifike në këtë fushë, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të kapitullit IB, “Komoditeti i udhëtimit”, lëshon për çdo autobus dokumentin në përputhje me aneksin 2 të këtij udhëzimi. Ministria, gjatë një periudhe pesëvjeçare do të miratojë një numër të kufizuar prej jo më shumë se dy organizmash, për të vlerësuar ecurinë e këtij procesi gjatë kësaj periudhe dhe për të ndërmarrë hapat e mëtejshëm”.

2. Paragrafi i tretë, i pikës 8(a), të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë:

“Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve brenda vendit është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose të hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga DPSHTRR-ja dhe, ose refuzohet lëshimi i tij nga organi i miratuar, derisa këto kushte të plotësohen. Dokumenti mbahet në origjinal në autobus dhe u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet prej tyre.”.

3. Paragrafi i dytë, i pikës 9 të shkronjës “B”, të kapitullit I riformulohet si më poshtë:



“Për kontrollin në plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, organi i miratuar, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të kapitullit IB, “Komoditeti i udhëtimit”, lëshon për çdo autobus dokumentin në përputhje me aneksin 1, të këtij udhëzimi.”.

4. Paragrafi i katërt, i pikës 9, të shkronjës “B”, të kapitullit I, riformulohet si më poshtë:

“Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose të hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga DPSHTRR-ja dhe, ose refuzohet lëshimi i tij nga organi i miratuar, derisa këto kushte të plotësohen. Dokumenti mbahet në origjinal në autobus dhe u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet prej tyre.”.

5. Shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të kapitullit IV, riformulohen si më poshtë:

“9 a) Organi i miratuar në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe të veçanta, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të këtij kapitulli “Kushte të veçanta të automjetit në shërbimin “taksi”, lëshojnë për autoveturën në shërbimin taksi dokumentin në përputhje me aneksin 3 të këtij udhëzimi. Aktivlerësimi i kushteve në shërbimin taksi për autoveturën në shërbimin taksi lëshohet çdo vit, pasi autovetura ka kaluar kontrollin teknik periodik dhe vjetor dhe është pajisur me certifikatën e

kontrollit teknik të mjeteve rrugore, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 11.3.2010, “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”.

b) Organi i miratuar në plotësimin e kushteve të komoditetit dhe të veçanta, nuk kryen veprime lidhur me plotësimin e dokumentit sipas aneksit 3 të këtij udhëzimi, nëse një autoveturë e shërbimit taksi e licencuar në bashki, jo qendër rrethi/komune ka ngjyrë të verdhë, ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave të njëjta me autoveturat e licencuara në shërbimin taksi në bashkinë qendër rrethi, si dhe kur nuk plotëson dispozitat e pikës 3, të nenit 236, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, “Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të kapitullit IV të udhëzimit.

c) Aktivlerësimi i kushteve të komoditetit dhe të veçanta në shërbimin taksi është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose të hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga DPSHTRR-ja dhe, ose refuzohet lëshimi i tij nga organi i miratuar, derisa këto kushte të jenë plotësuar.”.

10. Anekset 1, 2 dhe 3 ndryshohen sipas anekseve bashkëlidhur.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri



Aneksi 1 ndryshohet si vijon:

(letër me ngjyrë të bardhë, format: DIN A4)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 (EMËRTIMI I OMVK-së)

AKTVLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT, TË AUTOBUSËVE NË
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IB, komisioni i ngritur për kontrollin në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin e udhëtarëve, kontrollon autobusin:

Targa:.....
 Marka:.....
 Tipi:.....
 Nr. i shasisë:.....
 Viti i prodhimit:.....
 Nr. i vendeve:.....
 Numri i lejes së qarkullimit:.....
 Emri i subjektit transportues:.....
 Adresa e plotë e subjektit:.....
 Me seli në qytetin:.....

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të veçanta që kërkon udhëzimi,

OMVK-ja vlerësoi:

Se autobusi i mësipërm plotëson kushtet e komoditetit në transportin e udhëtarëve, sipas kapitullit IB, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

PERSONAT QË INSPEKTUAN AUTOBUSIN

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

DREJTUESI TEKNIK

 (emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____, i vlefshëm deri _____

Shënim. Ky dokument mbahet në mjet, në origjinal.



Aneksi 2 ndryshohet si vijon:

(letër me ngjyrë të bardhë, format: DIN A4)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 (EMËRTIMI I OMVK-së)

AKTVLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT, TË AUTOBUSËVE NË
TRANSPORTIN E UDHËTARËVE BRENDË VENDIT

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IB, komisioni i ngritur për kontrollin në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve në transportin e udhëtarëve, kontrolloi autobusin:

Targa:.....
 Marka:.....
 Tipi:.....
 Nr. i shasisë:.....
 Viti i prodhimit:.....
 Nr. i vendeve:.....
 Numri i lejes së qarkullimit:.....
 Emri i subjektit transportues:.....
 Adresa e plotë e subjektit:.....
 Me seli në qytetin:.....

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të veçanta që kërkon udhëzimi,

OMVK-ja vlerësoi:

Se autobusi i mësipërm plotëson kushtet e komoditetit në transportin e udhëtarëve sipas kapitullit IB, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

PERSONAT QË INSPEKTUAN AUTOBUSIN

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

DREJTUESI TEKNIK

 (emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____, i vlefshëm deri _____

Shënim. Ky dokument mbahet në mjet, në origjinal.



Aneksi 3 ndryshohet si vijon:

(letër me ngjyrë të bardhë, format: DIN A4)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 (EMËRTIMI I OMVK-së)

AKTVLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT DHE TË VEÇANTA TË
AUTOVETURËS NË SHËRBIMIN TAKSI

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IV, komisioni i ngritur për kontrollin e plotësimit të kushteve të veçanta në shërbimin taksi, kontrolloi autoveturën:

Targa:.....
 Marka:.....
 Tipi:.....
 Nr. i shasisë:.....
 Viti i prodhimit:.....
 Nr. i vendeve:.....
 Numri i lejes së qarkullimit:.....
 Emri i subjektit transportues:.....
 Adresa e plotë e subjektit:.....
 Me seli në njësinë e qeverisjes vendore bashkia/komuna:.....
 Stema e njësisë së qeverisjes vendore:
 Tarifat e shërbimit:
 Ngjyra në përputhje me vendimin e njësisë së qeverisjes vendore

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të komoditetit e të veçanta që kërkon udhëzimi,

OMVK-ja vlerësoi:

Se autovetura e mësipërme plotëson kërkesat për shërbimin taksi të udhëtarëve, sipas kapitullit IV, të udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

PERSONAT QË INSPEKTUAN AUTOBUSIN

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

 (emri, mbiemri, firma)

DREJTUESI TEKNIK

 (emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____, i vlefshëm deri _____
 Shënim. Ky dokument mbahet në mjet, në original.

**UDHËZIM****Nr. 18, datë 21.5.2018****PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018–2019”,

UDHËZOJ:**KREU I****PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT**

1. Aplikimi i maturantëve/i kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e Maturës Shtetërore *online*: www.matura.qsha.gov.al

2. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar *online* formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në portalin maturanti: www.rezultateam.al

3. Për maturantët e vitit shkollor 2017–2018, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në portalin *online* të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm. Deri më 31 maj 2018, hidhen rezultatet e të gjitha viteve të arsimit të mesëm, me përjashtim të rezultateve të vitit të fundit. Rezultatet e vitit të fundit hidhen gjatë muajit qershor, pas përfundimit të vitit shkollor.

4. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm, përpara vitit shkollor 2017–2018 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2018, në portalin *online* të maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

5. Për kandidatët, që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2018, në portalin *online* të maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e njësuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

6. Përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2018–2019, të bëhet në portalin e aplikimit universitar U-Albania: <http://ualbania.arsimi.gov.al>

7. Regjistrimi i studentëve fitues, të shpallur nga IAL-të të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe të pasqyrohen në portalin e aplikimit universitar U-Albania: <http://ualbania.arsimi.gov.al>

KREU II**RAUNDI I PARË****A. Procedurat e aplikimit**

1. Maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *online* në portalin e aplikimit universitar U-Albania.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;

b) Plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik;

c) Plotësojnë kriteret shitesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë;



d) Nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Pagesa kryhet në periudhën 5 qershor deri 15 korrik. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer në portalin U-Albania brenda datës 20 korrik 2018.

4. Në periudhën 30 korrik–4 gusht 2018, maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit do të aplikojnë në portalin U-Albania, nëpërmjet formularit *online* të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018 dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.

5. Maturantët/kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018.

6. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti, sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të portalit U-Albania.

7. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/jopublike, për vitin akademik 2018–2019.

8. DAR/ZA-të duhet të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

9. Portali U-Albania nuk do të pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B. Përcjellja e të dhënave dhe e rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/të kandidatëve të renditur

1. Në datën 31 maj 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-së, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z.

2. Brenda datës 28 korrik 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo maturant/kandidat:

- ID e maturës;
- Numrin personal të maturantit/kandidatit;
- Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

e) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

f) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

g) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

h) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

3. Brenda datës 10 gusht 2018, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë nga portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

4. Në datën 10 gusht 2018, të gjitha IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11–22 gusht 2018 do të zhvillohen konkursat e pranimit.

5. Deri në datën 13 gusht 2018 RASH-ja i përcjell QSHA-së listën e aplikantëve për çdo program studimi.

6. Pas datës 23 gusht 2018, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) Listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;

b) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

c) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

d) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

f) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

g) Indekset e profileve të shkollave të mesme.



7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përlogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës 28 gusht 2018, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 28 gusht 2018, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Gjithashtu, brenda datës 28 gusht 2018, IAL-të i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 30 gusht deri 12 shtator 2018, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet nga ora 08:00 deri në orën 16:30.

2. Periudha 30 gusht deri 12 shtator është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) Nuk përcaktohen kriteret shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;

b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

4. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe RASH-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe <http://ualbania.arsimi.gov.al>

5. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe *online* vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

6. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 12 shtator 2018. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e parë.

7. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria mësimore e fakultetit bën regjistrimin *online* në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

8. Sekretariatë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani



të aplikantit kryhet regjistrimi *online* në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

9. Brenda datës 14 shtator 2018, IAL-të përcjellin në QSHA dhe RASH regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në *hardcopy*.

10. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

Ç. Procesi i çregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datën 13 shtator 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së dhe RASH-së, brenda datës 14 shtator 2018, listën e aplikantëve të çregjistruar.

D. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën 29 gusht 2018. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik në portalin U-Albania, brenda datës 31 gusht 2018, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm në datën 13 shtator 2018.

KREU III RAUNDI I DYTË

A. Procedurat e aplikimit

1. Në periudhën 15–20 shtator 2018 do të kryhet procesi i aplikimit *online* për raundin e dytë në portalin U-Albania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 (dhjetë) preferenca, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që:

a) Nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;

b) Kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;

c) Kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;

d) Janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përsëhkuara në udhëzuesin teknik të publikuar në portalin e aplikimit universitar U-Albania).

3. Deri në datën 10 shtator 2018, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni, hidhen në portalin *online* të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

4. DAR/ZA-të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'u ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

5. Maturantët/kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në portalin U-Albania, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit.

B. Përcjellja e të dhënave dhe e rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur



1. Brenda datës 14 shtator 2018, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

- a) ID e maturës;
- b) Numrin personal të maturantit/kandidatit;
- c) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- d) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
- e) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- f) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
- g) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;

h) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

2. Pas datës 21 shtator 2018, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

- a) Listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
- b) Notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- c) Rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
- d) Mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- e) Mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
- f) Mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018;
- g) Indekset e profileve të shkollave të mesme.

3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

4. Brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Gjithashtu, brenda datës 25 shtator 2018, IAL-të i përcjellin një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 27 shtator deri 6 tetor 2018, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet nga ora 8:00 deri në orën 16:30.

2. Periudha 27 shtator deri 6 tetor 2018 është e ndarë në 5 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

- a) Nuk përcaktohen kriteret shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare;
- b) Numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

Nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

4. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 fazave 48-orëshe, MASR-ja dhe QSHA-ja do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe <http://ualbania.arsimi.gov.al>

5. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe *online* vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të dytë. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e dytë.



6. Sekretaritë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin *online* në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopia;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njëzuar në MASR;

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

7. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi *online* në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

8. Brenda datës 22 tetor 2018, RASH-ja dhe IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe *hardcopy*.

9. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

Ç. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën 26 shtator 2018. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA brenda datës 28 shtator 2018, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe

pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të rregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm në datën 7 tetor 2018.

D. Procesi i rregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të rregjistrohet vetëm në datën 7 tetor 2018. Ai paraqet një kërkesë për rregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Rregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mësimore, pas rregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së dhe RASH-së, brenda datës 9 tetor 2018, listën e aplikantëve të rregjistruar.

KREU IV RAUNDI I TRETË

1. Gjatë periudhës 9 deri më 13 tetor 2018, IAL-të vijnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e dytë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve përcaktohen nga njësitë kryesore të IAL-ve.

2. Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, njësitë bazë në institucionet e arsimit të lartë, përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë, në datat 15–18 tetor 2018. Kandidatët përzgjidhen dhe rankohen nga njësitë



bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, duke ngarkuar një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Sekretaritetë mësimore regjistrojnë kandidatët e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas renditjes deri në plotësimin e kuotave për programet përkatëse të studimit.

3. Regjistrimi i kandidatit sipas pikës 2, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarisë mësimore në datat 19–20 tetor 2018, nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.

4. Sekretaritetë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin *online* në portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njëzuar në MASR;

c) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

5. Sekretaritetë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi *online* në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

6. Brenda datës 29 tetor 2018, RASH-ja dhe IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të tretë në format elektronik dhe *hardcopy*.

7. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për këtë vit akademik.

KREU V DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI

1. Portali Matura Shtetërore *online* është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a) Procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore 2018;

b) Digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;

c) Prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.

2. Portali Maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

a) Procesin e regjistrimit dhe të administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin Matura Shtetërore *online*;

b) Ndërveprimin me portalin U-Albania nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve aplikues me formularët A1/A1Z;

c) Prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.

3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:

a) Informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për vitin akademik 2018–2019 dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar:

i) kriteret e pranimit;

ii) kuotat e pranimit;

iii) programet mësimore, kurrikulat etj.

b) Procesin e përzgjedhjes nga maturantët/kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2018–2019.

c) Përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.

d) Procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidateve në rang kombëtar sipas renditjes dhe përlogaritjes së pikëve nga IAL-të.



e) Procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve në IAL-të publike dhe jopublike për ciklin e parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2018–2019.

f) Sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës së kuqe.

g) Dhënie *online* të informacioneve të nevojshme për maturanët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE

1. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASR-së.

2. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017–2018 do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASR-së.

3. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MASR-së.

4. Aplikimi për programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, si dhe programet specializues afatgjatë do të bëhen në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimeve të posaçme të MASR-së.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor 2018, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënie e numrave të matrikullimit”, si dhe deklaratën sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. QSHA-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2018, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.

2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. Ky raport të dërgohet në MASR brenda datës 31 dhjetor 2018.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, DAR/ZA-të dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



SHTOJCA NR. 1 DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm, se në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: _____

Data: ____ . ____ . ____

VENDIM

Nr. 35, datë 22.5.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KAVAJË SHA

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar dhe në raportin nr. 64/2, datë 15.5.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi:

Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. i ka përfunduar afati i licencës në datën 15.3.2017

dhe ushtron veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë nga Enti Rregullator i Ujit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullore ndaj Entit Rregullator të Ujit në vlerën 5 311 600 (pesë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontratat mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., datë 12.1.2009 dhe kontratës datë 26.7.2010.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., për kundërvajtjet administrative:

a) Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë;

b) Mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 36, datë 22.5.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MARRJEN E MASAVE
ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË
UJËSJIELLËS TROPOJË SHA**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe në raportin e inspektimit nr. 65/1, datë 17.5.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi:

Shoqërisë Ujësjiellës Tropojë sh.a. i ka përfunduar afati i licencës në datën 13.6.2016 dhe ushtron veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë nga Enti Rregullator i Ujit, në

kundërshtim me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

Shoqëria ka depozituar kërkesën për rilicencim dhe dokumentacionin bashkëlidhur pranë Entit Rregullator të Ujit me nr. 257/3 prot., datë 22.5.2018.

Shoqëria Ujësjiellës Tropojë sh.a. aplikon tarifë për konsumatorët familjarë për qytetin e Bajram Currit dhe tarifë shërbimi për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në kundërshtim me vendimin e KKRR-së nr. 29, datë 13.10.2004, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ujësjiellës Tropojë sh.a.”, si dhe në shkelje të pikës “b”, të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masës administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës Tropojë sh.a. për kundërvajtjen administrative:

a) Moszbatimi i vendimeve të Entit Rregullator për tarifat.

2. Shoqëria Ujësjiellës Tropojë sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës Tropojë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë